

KUJDES KUJT I BESONI!

PARANDALOJE TRAFIKIMIN ME PERSONA



INFORMOHU
RAPORTO

THIRR FALAS
0800 11112

Arbenita ishte pa punë dhe gjendja financiare e saj dhe e prindërve të saj ishte shumë e vështirë. Një grua që ajo e njihte, e njoftoi me dikë që mund t'i ndihmonte për të gjetur punë si kameriere në një qytet tjetër. Ajo u ndihmua duke iu siguruar transporti dhe vendi për të jetuar dhe iu tha që mund ta kompensojë personin më vonë. Kur ajo arriti aty, ajo iu dorëzua një grupi të meshkujve, të cilët ia morën dokumentet e identifikimit, i thanë që ajo kishte i para borxh atyre dhe që duhej t'i paguante borxhet e saj. Tani, ajo është e detyruar të ofrojë shërbime seksuale.

Si rekrutohen viktimat nga trafikantët?

Trafikantët i rekrutojnë viktimat e tyre duke e shfrytëzuar cenueshmërinë dhe shpresën e tyre për një të ardhme më të mirë. Ata u premtojnë punë dhe të ardhura e pastaj krijojnë situata të varësisë financiare dhe viktimat i mbajnë në mënyrë të dhunshme.

Për të marrë më shumë informata për trafikimin me qenie njerëzore, kuptoni kush mund të bëhet viktimë e trafikimit me qenie njerëzore dhe raportoni për dyshimet tuaja, thirrni në linjën për ndihmë 080 11112

 TË GJITHA THIRRJET JANË FALAS
DHE KONFIDENCIALE

Çka është trafikimi me persona?

Trafikimi me persona është formë e skllavërisë moderne. Trafikantët i rekrutojnë, mashtrojnë dhe transferojnë viktimat e tyre. Ata përdorin forcën ose i rrëmbejnë ato; ndonjëherë ata e shfrytëzojnë pozitën e tyre ose dobësinë e personit. Trafikantët kanë vetëm një qëllim në mendje: t'i shfrytëzojnë viktimat e tyre. Shfrytëzimi mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë: shfrytëzimin seksual, punën e dhunshme, robërimin ose heqjen e organeve.

Kujdes kujt i besoni!
Informohu dhe raportoj!

MOS E FSHIH MË!

PARANDALOJE DHUNËN NË FAMILJE



INFORMOHU
RAPORTO

THIRR FALAS
0800 11112

Çka është dhuna në familje?

Dhuna në familje gjithashtu njihet si dhunë brenda shtëpisë. Është keqtrajtim fizik, seksual dhe emocional. Është krim që duhet të raportohet. Viktimat e dhunës në familje kanë të drejtë të pranojnë ndihmë.

Çka mund të bëhet për t'i ndihmuar viktimat e dhunës në familje?

Viktimat e dhunës në familje kanë të drejtë të marrin ndihmë, strehim në objekte të sigurta dhe riintegrim në shoqëri. Mbrojtësit e viktimave punojnë me viktimat e dhunës në familje në baza ditore për të siguruar ofrimin e ndihmës adekuate.

Drita dhe Agroni kanë dy fëmijë. Dje Agroni humbi punën. Kur u kthye në shtëpi, nuk e gjeti Dritën. Ajo kishte shkuar në shëtitje me fëmijët. Kur arritën në shtëpi, Agroni ishte duke shikuar televizionin dhe po pinte alkool. Ai filloi t'i bërtiste Dritës, që nuk e kishte përgatitur darkën dhe filloi ta rrihte para fëmijëve. Fëmijët u përpoqën ta parandalojnë që të mos e lëndonte nënën e tyre, por ai i lëndoi edhe ata.

0800 11112

 TË GJITHA THIRRJET JANË FALAS
DHE KONFIDENCIALE

Kush janë viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje?

Dhuna familjare mund të ndodhë në çdo familje. Ju mund të ndjeheni të abuzuar nëse dikush në familjen tuaj:

- Ju kërcënon ose ju lëndon juve, fëmijët tuaj ose anëtarët e familjes suaj;
- Vepron në mënyrë posesive dhe agresive ndaj jush;
- Vazhdimisht ju nënçmon ose fyen;
- Përpiqet t'ju frikësojë; dhe
- Përpiqet t'ju ketë nën kontroll.

Dhuna në familje ndodh. Mos e fshihni më! Ju lutem thirrni në linjën për ndihmë 080 11112